



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1200/13 prot.

Datë 28.05.2026

V E N D I M
Nr. 726/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.05.2026 me:

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 667/2026, datë 19.05.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-73462-12-29-2025, me objekt: “Dixhitalizimi i arkivës historike të OSHEE Group sh.a”, me fond limit 54,806,666.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “PC STORE” SHPK me NIPT L01606034A dhe adresë Rruga e Dibres, Vila nr.153, Kati i Pare.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a me adresë Bulevardi Gjergj Fishta, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 19.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 667/2026, ku vendosi:

- 1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-73462-12-29-2025, me objekt: “Dixhitalizimi i arkivës historike të OSHEE Group sh.a”, me fond limit 54,806,666.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.*
- 2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “PC Store” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

I.2. Me shkresën nr. 5075/2 prot., datë 25.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1200/10 prot., datë 28.05.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a., ka përcjellur rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas pjesës arsyetuese të vendimit nr. 667/2026 datë 19.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-73462-12-29-2025, me objekt: “Dixhitalizimi i arkivës historike të OSHEE Group sh.a”, me fond limit 54,806,666.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 5075/2 prot., datë 25.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1200/10 prot., datë 28.05.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a., ka përcjellur rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas pjesës arsyetuese të vendimit nr. 667/2026

datë 19.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe në zbatim të tij për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-73462-12-29-2025, me objekt: “Dixhitalizimi i arkivës historike të OSHEE Group sh.a”, me fond limit 54,806,666.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se autoriteti kontraktor ka bashkëngjitur dokumentat nga ku vërehen rivlerësimi sipas vendimit nr. 667/2026 datë 19.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga verifikimi i sistemit elektronike të Agjensisë së Prokurimit Publik konstatohet se autoriteti ka vijuar me rivlerësimin sipas vendimit të KPP për operatorin ekonomik duke zbatuar kështu vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-73462-12-29-2025, me objekt: “Dixhitalizimi i arkivës historike të OSHEE Group sh.a”, me fond limit 54,806,666.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

